Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 401/01
Datë 06.11.2015

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare të datës 7 nëntor 2008 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 4, 7, 10, 11, 16 dhe 17, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 06.11.2015 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për riakreditimin dhe rivalidimin e Qendrës Regjonale për Aftësim Profesional, në Mitrovicë për periudhën 06.11.2015 deri 06.11.2018 për të ofruar:

1.1 Teknologji Informative dhe të Komunikimit, niveli II i KKK.

Riakreditimi dhe rivalidimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Sistemi operativ dhe pako e aplikacionit të MS Office të jenë të licencuar.
- Grupet e trajnimeve të jenë homogjene.
- Provimet të mbahen për pjesën praktike.
- Të krijohet një bazë e të dhënave.
- Të rritet komunikimi ndërmjet QRAP dhe sektorit privat dhe publik.
- Të krijohet dhe të publikohet ueb sajti i QRAP.
- Të përdoren adresat zyrtare të e-Mail.
- Të angazhohet edhe një trajner.
- Mirëmbajtja teknike e kompjuterëve të bëhet në QRAP.
- Të krijohet rrjeti i kompjuterëve dhe të gjithë kompjuterët të kenë qasje në internet.

- Të parashihet vija buxhetore për ngritjen e kapaciteteve të trajnerit.
- Pjesëmarrësit në trajnime duhet të angazhohen edhe me detyra shtesë të cilat i realizojnë jashtë ambientit të QRAP.
- Pjesëmarrësit në trajnim të nënshkruhen në listën e vijueshmërisë.
- Të organizohet puna praktike.
- Mbrojtja e të dhënave personale.
-

(Afati kohor i këtyre kushteve: 01.06.2016).

1.2 Saldim, niveli III i KKK.

Riakreditimi dhe rivalidimi i institucioni/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim:

Kushtet:

- Rekomandohet Trajneri i Kursit për Saldues të angazhohet rreth rifreskimit të Programit të kursit për Saldues në module profesionale të caktuara.
- Rekomandohet trajneri të bëjë rifreskimin e kërkesave (pyetjeve) të testit teorik dhe praktik për secilën njësi modulare përkatëse si dhe testit përfundimtarë në pjesën teorike dhe praktike në nivel të kualifikimit.
- Rekomandohet kompletimi i kabinetit me pajisje për ekzaminim e lidhjeve të salduara-pajisja me ultratingull, penetrim.
- Në listën e evidencës së kandidatëve të praktikohet nënshkrimi për vijueshmërin e tyre në vend të shënjave (+) apo (-).

(Afati kohor i këtyre kushteve: 01.06.2016).

1. Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit, Këshilli Drejtues i AKK-së merr këtë vendim bazuar në rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara dhe këto rekomandime janë të mbështetura në fakte dhe dokumente si në vijim:

- Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit;
- Aplikacioni për Akreditim si Institucionit Ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit;
- Raporti i Vetë-vlerësimit;
- Vizita në institucionin/ofruesin aplikues, dhe
- Dokumente tjera shtesë.

2.1 Pala e pakënaqur me vendimin, ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen në afatin e caktuar nga AKK, në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimin dhe akreditimit.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi i dërgohet:

- QRAP Mitrovicë;
- AKK.



Nën- Kryetari i KD së AKK-së
Anton Gojani